



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHE

Nr. _____ Prot.

Lezhë, më ____/____/2026

Shtojca 15.

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM
NË MARRËVESHJEN KUADËR, NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT**

Data 01/09/2026.

Drejtuar:

Operatorit Ekonomik (OE) ☒ ose

“PE - VLA - KU” Shpk, me Nuis K61716013M dhe me adrese Njesia Bashkiake Nr. 9, Rruga Muzaket, Pallatet Vokshi, Hyrja 1, Kati . 7, Tirane,

- OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ **JO** ☒

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐ **JO** ☒

Drejtuar:

Operatorit Ekonomik (OE) ☒ ose

“RAFIN COMPANY” Shpk, me Nuis L52125110A dhe me adrese Rruga”Haxhi Kika”, Njesia administrative nr. 5, nr.pasurie 6/538 hyrja 1, apartamenti 4, Tirane

- OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ **JO** ☒

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐ **JO** ☒

Tipi i Kontratës: Pune.

Lloji i Procedurës së prokurimit: E Hapur.

Numri i Procedurës / Referenca e Lotit: REF-91732-06-30-2026.

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Ndertimi i Parkut “Nene Tereza” dhe Pedonales “Faik Konica”, Lezhe”.

Kohëzgjatja e kontratës: 12 Muaj nga data e nënshkrimit të Marreveshjes Kuader.

Data e Publikimit në SPE, të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit/Njoftimit të anulimit nga i cili nisin afatet e ankimit: 24/08/2026.

¹Data e Publikimit në Buletinin e Njoftimeve Publike, të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit /Njoftimit të Anulimit nga i cili nisin afatet e ankimit: Buletini Nr. 55, datë 31 Gusht 2026.

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto ☐
- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të kësaj bëjmë me dije se, në këtë procedurë /lot kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë me vlerat përkatëse si më poshtë:

- 1- Bashkimi i Operatoreve Ekonomik “2Z KONSTRUKSION” Shpk, me Nuis J63229466K & “NDREGJONI” Shpk, me Nuis K31329048I dhe me oferte ekonomike 109,366,316 (njqind e nente milion e treqind e gjashtedhjetë e gjashtë mijë e treqind e gjashtembedhjetë) Lek pa Tvsh,

OE “2Z KONSTRUKSION” Shpk, me pjesëmarrje prej 51 %

OE “NDREGJONI” Shpk, me pjesëmarrje prej 49 %

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐ JO X

- 2- Operatori Ekonomik “INA” Shpk, me Nuis J61814009W dhe me oferte ekonomike 83,885,141 (tetedhjetë e tre milion e teteqind e tetedhjetë e pesë mijë e njqind e dyzet e nje) Lek pa Tvsh,

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐ JO X

- 3- Operatori Ekonomik “MELA.” Shpk, me Nuis K62320011G dhe me oferte ekonomike 95,219,659.25 (nentedhjetë e pesë milion e dyqind e nentembedhjetë mijë e gjashtëqind e pesedhjetë e nente pike njezet e pesë) Lek pa Tvsh,

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐ JO X

¹ Në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore, plotësohet vetëm data e publikimit të këtyre njoftimeve në BNJP

- 4- Operatori Ekonomik “PE - VLA - KU” Shpk, me Nuis K61716013M dhe me oferte ekonomike 97,840,578.5 (nentedhjetë e shtatë milion e tetëqind e dyzet mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e tetë pike pese) Lek pa Tvsh,

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐ JO X

- 5- Operatori Ekonomik “RAFIN COMPANY” Shpk, me Nuis L52125110A dhe me oferte ekonomike 101,416,948.75 (njëqind e një milion e katërqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e nentëqind e dyzet e tetë pike shtatëdhjetë e pese) Lek pa Tvsh,

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐ JO X

- 6- Bashkimi i Operatoreve Ekonomik “T & XH” Shpk, me Nuis L72121504I & “AGRO - KORANI” Shpk, me Nuis L13329801V dhe me oferte ekonomike 92,626,268.9 (nentedhjetë e dy milion e gjashtëqind e njëzet e gjashtë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e tetë pike nente) Lek pa Tvsh,

OE “T & XH” Shpk, me pjesëmarrje prej 96.3 %

OE “AGRO - KORANI” Shpk, me pjesëmarrje prej 3.7 %

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐ JO X

Janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

I- Bashkimi i Operatoreve Ekonomik “2Z KONSTRUKSION” Shpk, me Nuis J63229466K & “NDREGJONI” Shpk, me Nuis K31329048I,

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga Operatori Ekonomik rezulton se:

Se pari, nuk plotëson kriterin 2.3.1 të DST-se ku parashikohet se: “Operatoret Ekonomike duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme **të ngjashme:**

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës,

ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

- Për kontrata të realizuara me autoritete publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Formularin e vlerësimit;
2. Kontratën/Kontratën;
3. Situacionin përfundimtar;
4. Akt Kolaudimi
5. Faturat tatimore të deklaruara në organet tatimore;
6. Çertifikatën e marrjes në dorezim/ Çertifikatën e perhershme të marrjes në dorezim

-Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Kontratë sipermarrje;
2. Leje për kryerje punimesh
3. Situacionin përfundimtar;
4. Fatura tatimore të deklaruara në organet tatimore;
5. Çertifikatën e marrjes në dorezim/Çertifikatën e perhershme të marrjes në dorezim;

Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtarë i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Shenim: Për punët e ngjashme të realizuara si BOE krahas dokumenteve të mesipërme duhet të paraqitet edhe kontrata e bashkepunimit ku përcaktohet ndarja e zerave të punimeve ndërmjet paleve, ndërsa për punët e ngjashme të realizuara si nenkontraktor duhet të paraqitet kontrata e nenkontraktimit ku përcaktohen zerat e punimeve si dhe miratimi i autoritetit kontraktor/investitorit”.

Thëksojmë se për të përmbushur pikën 2.3.1, në lidhje me dëshmitë për përvojën e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, OE duhet të paraqesin dokumentacion për realizimin e punëve të ngjashme me vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet për një objekt të vetëm ose punë të ngjashme ku vlera totale e punëve është jo më të vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Po ashtu duhet të paraqesin dokumentacionin e kërkuar për kontratat të realizuara me autoritete publike apo për kontrata të realizuara me sektorin privat.

Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se njëri nga operatorët ekonomik pjesë e BOE-së konkretisht OE “2Z KONSTRUKSION” SH.P.K, ka paraqitur si punë të ngjashme vetëm 2 (dy) kontrata të realizuara me objekt “Ndërtim i Stacionit të Policisë Roskovec” dhe “Riforcimi i njesive të banimit në ndërtesat (pallat), në kuadër të procesit të rindërtimit, në territorin e Bashkisë Lezhë, Loti II”.

Thëksojmë se për të përmbushur pikën 2.3.1, në lidhje me dëshmitë për përvojën e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, OE

duhet të paraqesin dokumentacion per realizimin e puneve te ngjashme me vlere jo me te vogel se 50 % e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet per nje objekt te vetem ose pune te ngjashme ku vlere totale e puneve eshte jo me te vogel se dyfishi i vleres limit te kontrates qe prokurohet.

Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se operatori ekonomik nuk ka paraqitur pune te ngjashme sipas objektit te percaktuar ne DST, pasi punet e paraqitura nga ky operator ekonomik jane te karakterit “Ndertime Civile dhe Industriale” dhe “Rikostruksion dhe Mirembajtje godinash civile e industriale dhe Veshje Fasada”, te cilat nuk jane te ngjashme me punime te karakterit “Rruge, punime ne sheshe etj”, e per rrjedhoje duke mos qene te ngjashme me objektin e prokurimit.

Si me siper, operatori ekonomik nuk plotëson kërkesat e parashikuara ne DST për eksperiencat e mëparshme të ngjashme dhe ky kriter konsiderohet i papermbushur.

Sa me siper Komisioni i Vleresimit te Ofertave mbeshtetur nenin 77, pika 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve, si dhe ne në nenin 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, vendosi te refuzoje oferten e BOE “2Z KONSTRUKSION” Shpk, me Nuis J63229466K & “NDREGJONI” Shpk, me Nuis K31329048I, per mos permbushje te kriterëve te vecanta kualifikuese.

Si perfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, BOE “2Z KONSTRUKSION” Shpk, me Nuis J63229466K & “NDREGJONI” Shpk, me Nuis K31329048I, skualifikohet.

II- Operatoreve Ekonomik “INA” Shpk, me Nuis J61814009W,

Nga verifikimi i dokumentacionit te paraqitur nga Operatori Ekonomik rezulton se:

Se pari, nuk ploteson kriterin 2.3.1 te DST-se ku parashikohet se: “Operaret Ekonomike duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës,

ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

- Për kontrata të realizuara me autoritete publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Formularin e vlerësimit;
2. Kontratën/Kontratata;
3. Situacionin përfundimtar;
4. Akt Kolaudimi
5. Faturat tatimore te deklaruar ne organet tatimore;
6. Çertifikaten e marrjes ne dorezim/ Çertifikaten e perhershme te marrjes ne dorezim

-Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Kontratë sipermarrje;
2. Leje per kryerje punimesh
3. Situacionin përfundimtar;
4. **Fatura tatimore te deklaruar ne organet tatimore;**
5. Çertifikaten e marrjes ne dorezim/Çertifikatën e perhershme të marrjes ne dorezim;

Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Shenim: Per punet e ngjashme te realizuara si BOE krahas dokumenteve te mesiperme duhet te paraqitet edhe kontrata e bashkepunimit ku percaktohet ndarja e zerave te punimeve ndermjet paleve, ndersa per punet e ngjashme te realizuara si nenkontraktor duhet te paraqitet kontrata e nenkontraktimit ku percaktohen zerat e punimeve si dhe miratimi i autoritetit kontraktor/investitorit”.

Theksojme se per te permbushur piken 2.3.1, ne lidhje me dëshmitë për pervojen e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë pese viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, OE duhet te paraqesin dokumentacion per realizimin e puneve te ngjashme me vlere jo me te vogel se 50 % e vlerës së përllëgaritur të kontratës që prokurohet per nje objekt te vetem ose pune te ngjashme ku vlere totale e puneve eshte jo me te vogel se dyfishi i vleres limit te kontrates qe prokurohet. Po ashtu duhet te paraqesin dokumentacionin e kerkuar per kontratat të realizuara me autoritete publike apo per kontrata të realizuara me sektorin privat.

Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se Operatorët Ekonomik ka paraqitur si pune te ngjashme vetem 1 (nje) kontrate të realizuara me sektorin privat, me objekt: *“Punime Civile dhe Mekanike KRAKOW, BALICE, POLONI”*.

KVO verën se Operatori Ekonomik ka paraqitur ne SPE nje deklarate per punen e ngjashme ku deklarën se:

“Deklaroj qe puna e ngjashme e paraqitur ne kete procedure ka si Autoritet Kontraktor nje institucion te huaj (NATO SUPPORT AND PROCUREMENT AGENCY) dhe procedura eshte zhvilluar ne nje shtet tjetër (POLONI) konform ligjeve dhe rregullave te ketij te fundit. Per sa me siper, ne perfundim te punimeve ky autoritet na ka pajisur me nje certificate marrje ne dorezim ose certificate pranimi ne te cilen inkorporohen dhe pasqyrohet te gjithë te dhenat e objektit, dorezimi, pranimi dhe realizimi me sukses i punimeve (ekuivalent me formularin e vleresimit & kolaodimin)”.

KVO mban ne konsiderate se bazuar ne piken 6, te nenit 26, te VKM-se nr. 285 date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, i ndryshuar, parshikohet se: ***“Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj. Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur”***.

KVO verën se ne deklaraten e paraqitur nga OE deklarohet se **autoriteti huaj e ka pajisur me nje certificate marrje ne dorezim** ose certificate pranimi ne te cilen inkorporohen dhe pasqyrohet te gjithë te dhenat e objektit, dorezimi, pranimi dhe realizimi me sukses i punimeve **(ekuivalent me formularin e vleresimit & kolaodimin)**.

Sa me siper, deklarata e Operatorit Ekonomik i referohet plotesimit te kriterit per

- formularin e vleresimit &
- kolaudimin

KVO mban ne konsiderates se per punet e ngjashme të realizuara me sektorin privat, OE duhet të paraqesin: Kontratë sipermarrje, **Leje per kryerje punimesh**, Situacionin përfundimtar, **Fatura tatimore**, dhe Çertifikaten e marrjes ne dorezim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes.

Nga verifikimi i dokumentacionit ne SPE rezulton se OE **“INA” SH.P.K** per objektin e sipercituar ka paraqitur Kontratë sipermarrje, Situacionin përfundimtar dhe Çertifikaten e marrjes ne dorezim por nuk ka paraqitur **Leje per kryerje punimesh dhe Fatura tatimore**, dokumenta keta te kerkuar ne kriterin 2.3.1 te Dokumentave Standarte te Tenderit.

KVO veren se dhe ne kontraten e sipermarrjes te paraqitur nga ky OE, rezulton se palet kane rene dakord qe per cdo punim te realizuar Kontraktuesi do të dorëzojë faturat e tij origjinale me dokumentacion mbështetës si me poshte vijon:

“8 Faturimi”

“8.2.1 Për qëllime të kontabilitetit dhe faturimit (duke përdorur sisteme ndërmarrjes NSPA bazuar në një platformë SAP), NSPA do të lëshojë (a) PO(a) për vlerën e rënë dakord të shërbimeve që do të ofrohen nga Kontraktori.

8.2.2 Kontraktuesi do të dorëzojë faturat e tij origjinale me dokumentacion mbështetës. Ajo do të mbajë numrin e kontratës dhe, nëse është e aplikueshme, numrin e Marrëveshjes Suplementare, dhe një përshkrim të shërbimeve me të cilat ato lidhen. Paraqitja e kërkuar e faturës duhet të pasqyrojë informacionin e deklaruar në OP dhe t'i komunikohet kontraktuesit nga CO para se të dorëzohet fatura e pare.

8.2.3 Çdo faturë do të mbështetet nga certifikata përkatëse e përkohshme ose përfundimtare e inspektimit dhe pranimi (I&AC) e nënshkruar siç duhet nga Inxhinieri i Vendit të NSPA dhe zyrtari teknik (i lartë) siç kërkohet nga SoW dhe planet e kërkuara në të, përkatësisht Plani i Zbatimit të Projektit, Master Plani/Plani I Projektit, Plani i Plotë i Zbatimit (GANTT) dhe Orari i Punës. Faturat e dorëzuara dhe dokumentet përkatëse të I&AC do të kenë numrin e kontrates dhe do t'i referohen artikullit të linjës së shërbimit dhe, nëse është e aplikueshme, numrit të Marrëveshjes Suplementare dhe një përshkrim të punës me të cilën ato lidhen.

8.2.4 Deklarata e mëposhtme do të bëhet nga Kontraktuesi në çdo faturë të dorezuar:

Vërtetoj që kjo faturë është e saktë dhe drejtë, se pagesa nuk është marre dhe se çmimet/normat përjashtojnë të gjitha taksat dhe detyrimet nga të NSPA/NATO është i përjashtuar.”

8.2.5 Fatura përfundimtare sipas kësaj Kontrate duhet të shënohet si Faturë FINAL.

8.2.6 Përveç rasteve kur është rënë dakord reciprokisht ndërmjet Kontraktorit dhe NSPA-së, NSPA nuk do të jetë përgjegjëse për asnjë shpenzim që është bërë më shumë se 12 muaj përpara paraqitjes së një faturë dhe/ose pretendimi. Me kërkesë, Kontraktori duhet të demonstrojë se të gjitha kostot e bëra dhe të paraqitura për pagesë në faturën e tij janë bërë në përmbushjen e kërkesave për kontratën e parashikuar nga Kërkesa për Propozim (KPP) përkatëse”.

Si me sipër, duke qene se OE-se nuk plotëson kërkesat e parashikuara ne DST për eksperiencat e mëparshme të ngjashme ku mungon **Leje per kryerje punimesh dhe Fatura tatimore**, ky kriter konsiderohet i papermbushur.

Se dyti, nuk ploteson kriterin 2.3.5, te DST-se ku parashikohet se: “Krahas stafit teknik Operatoret Ekonomike duhet te kene te punesuar staf mbeshtetes si me poshte:

- | | | |
|--------------------------------|---------|------------------------|
| - Inxhinier Ndërtimi | 1 (nje) | Diplome Universitare |
| - Inxhinier Agromjedisi/pyjesh | 1 (nje) | Diplome Universitare |
| - Teknik ndertimi | 2 (dy) | Diplome shkolles mesme |

- Teknik Elektrik	1 (nje)	Diplome shkolles mesme
- Elektriçist	2 (dy)	Çertifikate/ Deshmi profesionale
- Betonues	2 (dy)	Çertifikate/ Deshmi profesionale
- Hekurkthyes	2 (dy)	Çertifikate/ Deshmi profesionale
- Karpentier	2 (dy)	Çertifikate/ Deshmi profesionale
- Plakashtues mermeri dhe guri	4 (kater)	Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale
- Saldator	1 (nje)	Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale
- Shofer	4 (kater)	Leje Drejtimi
- Manovrator	4 (kater)	Deshmi e Aftesise Profesionale (DAP)

Operatori ekonomik duhet te paraqes per stafin e mesiperm: Kontratat individuale te punës, Diplome Universitare/ Diplome e shkolles mesme/ Deshmite profesionale/ Deshmi te Aftesise Profesionale (DAP)/ Leje Drejtimi sipas shenimeve per cdo kategori te mesiperme si dhe stafi i mesiperm te figuroje ne listepagesat e shoqerise per periudhen Mars 2026 – Maj 2026.

V.O- Dokumentacioni (Diplomat/deshmite/certifikatat) qe nuk eshte leshuar sipas legjislacionit perkates te arsimimit profesional do te konsiderohen jo te sakta dhe behen shkak per veprime te metejshme sipas parashikimeve perkatese te ligjit te prokurimit publik.

Per profesionet si me sipër, operatori ekonomik duhet te plotesoje tabelën si me poshtë:

Nr.	Emer Mbiemer i punonjesit	Profesioni i punojesis ne certifikate/diplome	Emri i Institucioni publik/privat leshues i certifikates/diplomes	Numri indetifikues i certefikates/diplomes	Nr NIPT - (Ne rast se leshuesi eshte institucion privat)
1					
2					
.....					

Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatoret ekonomik te formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe tabelës se mesiperme, te cila duhet te dorezohet ne fazen e ofertimit ne SPE. Ndersa dokumentacioni provues i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit paraprak dhe fillimit te afateve te ankimimit.

KVO veren se bazuar ne piken 1 te nenit 26, te VKM-se nr. 285 date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, i ndryshuar, parshikohet se: *Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si prove paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose pale te treta, formularin përmbledhës të vetedeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla, dhe per te permbushur kete kriter operatoret ekonomik pjesmarres duhet te vetedeklarojne ne formularin permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se, te dhenat e stafit mbeshtetes qe disponon sipas percaktimeve te pikes 2.3.5 te DST-se.*

KVO mban ne konsiderate se bazuar ne Formularin Permbledhes te Vetedeklarimit te paraqitur prane Bashkise Lezhe nga Operatori Ekonomik “INA” SHPK rezulton se ky subjekt nder te tjera per permbushjen e kriterit 2.3.5 te DST-se ka deklaruar si me poshte:

- Z. A. Beshaj i punesuar prane shoqerise sone ne rolin e **Inxhinierit te agromjedisit**

- Z.E. Gjoksi, me profesion **Manovrator** Buldozerist, **i kontraktuar me mjetin.**

- Z. V. Canaliaj me profesion **Manovrator** Eskavatorist, **i kontraktuar me mjetin**

- Z. K. Gazheli me profesion **Shofer**, **i kontraktuar me mjetin**

- Z. A. Zane me profesion **Shofer**, **i kontraktuar me mjetin**

I. Ne lidhje me deklarimin per disponimin e Inxhinierit te Agromjedisit te pajisur me Diplome Universitare KVO veren se:

Nga verifikimi i dokumentacionit te paraqitur ne SPE, verehet se operatori ekonomik ne deklaraten per stafin mbështetës **1 (nje) Inxhinier Agromjedisi/pyjesh, ka deklaruar se disponon te punesuar** prane shoqerise ne rolin e Inxhinierit te Agromjedisit Z. A. Beshaj.

KVO gjate vleresimit te dokumentacionit te paraqitur nga ky Operator Ekonomik konstatoi se njekohesisht rezulton se per Z. A. Beshaj eshte deklaruar edhe ne rolin e furnitorit si Person Fizik.

Nisur nga konstatimi i mesiperm dhe dyshimi per deklarim qe përmban të dhëna të pasakta për qëllime kualifikimi, KVO i kerkoi nepermjet SPE-se Operatorit Ekonomik “INA” SH.P.K me daten 29.07.2026, sqarim dhe dokumentacion duke u bazur ne nenin 26/7, të VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar *ku parashikohet se “Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t’i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime”.*

Ne vijim, me daten 30.06.2026, Operatori Ekonomik “INA” SH.P.K, nepermjet Sistemit te Prokurimeve Elektronike paraqiti sqarimin e tij, ku nder te tjera thekson se **deklarimi** ne formular se Z. A. Beshaj eshte i punesuar prane shoqerise ne rolin e Inxhinierit te agromjedisit eshte nje gabim nga ana e punonjesit te caktuar per ngarkimin e dokumentacionit ne SPE, pasi Z. A. Beshaj nuk eshte i punesuar prane shoqerise “INA” SH.P.K dhe per rrjedhoje nuk figuron ne listepagesat e shoqerise per periudhen Mars 2026 – Maj 2026. Po ashtu ne SPE OE “INA” SH.P.K, nuk paraqiti asnje dokumentacion qe provon si pjese te stafit te tij Inxhinierin e Agromjedisit.

Komisioni i Vleresimit te Ofertave rithekson bindjen e tij se për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i plotesimit te kriterëve te vecanta te paraqitura ne DST, per tu permbushur njesoj nga te gjithë Operatoret Ekonomik pjesemarres është i një rëndësie thelbësore e me ndikim të drejtpërdrejtë në ligjmerine dhe efikasitetin e procedurës, ndaj edhe i qëndron strikt rregullimit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik si **lex specialis mbi lëndën.**

Sa me siper nga verifikimi i dokumentacionit ne SPE dhe pas sqarimit nepermjet SPE-se nga Operatori Ekonomik “INA” SH.P.K rezulton se ky operator nuk disponon te punesuar prane shoqerise 1 (nje) Inxhinier Agromjedisi/pyjesh dhe po ashtu nuk figuron ne listepagesat e shoqerise per periudhen Mars 2026 – Maj 2026.

Si perfundim KVO konstaton se Operatori Ekonomik “INA” SH.P.K nuk permbush kriterin 2.3.5, te DST-se ne lidhje me disponimin e 1 (nje) Inxhinier Agromjedisi/pyjesh.

II. Ne lidhje me deklarimin per disponimin e 4 (kater) shofer dhe 4 (kater) manovrator KVO veren se:

Bazuar ne Formularin Permbledhes te Vetedeklarimit te paraqitur prane Bashkise Lezhe nga Operatori Ekonomik “INA” SHPK rezulton se ky subjekt nder te tjera per permbushjen e kriterit 2.3.5 te DST-se per diponimin e shoferave dhe manovratoreve ka deklaruar si me poshte:

- Z.E. Gjoksi, me profesion **Manovrator** Buldozerist, **i kontraktuar me mjetin.**
- Z. V. Canaliaj me profesion **Manovrator** Eskavatorist, **i kontraktuar me mjetin**
- Z. K. Gazheli me profesion **Shofer, i kontraktuar me mjetin**
- Z. A. Zane me profesion **Shofer, i kontraktuar me mjetin**

KVO mban ne konsiderate se bazuar ne piken 1 te nenit 26, te VKM-se nr. 285 date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, i ndryshuar, parshikohet se: *Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si prove paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose pale te treta, formularin përmbledhës të vetedeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla, per te permbushur kete kriter operatoret ekonomik pjesmarres duhet te vetedeklarojne ne formularin permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se, te dhenat e stafit mbeshtetes qe disponon te punesuar dhe qe figuron ne listepagesat e shoqerise per periudhen Mars 2026 – Maj 2026, sipas percaktimeve te pikes 2.3.5 te DST-se.*

Nga verifikimi i Formularit Permbledhes te Vetedeklarimit te paraqitur ne SPE rezulton se Z. E. Gjoksi, Z. V. Canaliaj, Z. K. Gazheli, Z. A. Zane nuk jane te punesuar prane OE “INA SHPK dhe per rrjedhoje ky subjekt nuk disponon Kontrate Individuale te Punes me keta punonjes, si dhe keta punonjes nuk figurojne ne listepagesat e shoqerise “INA” SH.P.K per periudhen Mars 2026 – Maj 2026.

KVO mban ne konsiderate se cdo marredhenie pune e pa formalizuar ne perputhje me ligjit te nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar eshte absolutisht e pavlefshem.

Per me teper, KVO thekson se marredhenia e punesimit me shoferat dhe manovratoret ne formen “i kontraktuar me mjetin”, **ku nuk jane lidhur kontratat individuale te punes dhe nuk jane deklaruar ne listpagesat e shoqerise si punonjes eshte absolutisht e pavlefshem dhe bie ndesh**

me dispozitat e ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Per sa me lart, konstatohet se Operatori Ekonomik “INA” SH.P.K **nuk disponon te punesuar dhe te deklaruar ne listpagesat e shoqerise per periudhen Mars 2026 – Maj 2026 punonjesit Z. E. Gjoksi, Z. V. Canaliaj, Z. K. Gazheli, Z. A. Zane, dhe per me teper konstatohet se forma e marredhenies se punes npermjet kontrates se qirase me mjetin bie ne kundershkrim te hapur me ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.**

Per sa cituam me siper, si dhe bazuar ne dokumentacionin e dorezuar ne SPE rezulton se ky subjekt ka deklaruar te dhena te paverteta per qellime kualifikimi ne lidhje me zbatimin e dispozitave ligjore ne marredheniet e punes ku verehet se ka deklaruar si me poshte:

“D: DEKLARATA “Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës”

Deklarata Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklarohet nën përgjegjësinë time se:

- ***Operatori ekonomik INA SHPK garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.***
- ***Operatori ekonomik INA SHPK lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.***
- *Operatori ekonomik INA SHPK nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH”.*

Per sa me lart Komisioni i Vleresimit te ofertave vlereson se OE “INA” SH.P.K eshte ne situaten e shkeljes së detyrimeve të zbatueshme që lidhen me legjislacionin e punës te parashikuar ne nenin 76, pika 3, e ligjit nr. 162, date 23.12.2020 “Per prokurimin publik”, ne te cilin citohet se: *“Çdo operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në procedurën e prokurimit nëse është në një nga situatat e mëposhtme: a) autoriteti ose enti kontraktor provon se ka shkelje të detyrimeve të zbatueshme që lidhen me legjislacionin për mbrojtjen nga diskriminimi, legjislacionin mjedisor, social, të punës, në fuqi apo me marrëveshjet kolektive dhe aktet e së drejtës ndërkombëtare në lidhje me këto fusha, ku Republika e Shqipërisë është palë;*

Sa me siper nga verifikimi i Formularit Permbledhes te Vetedeklarimit te paraqitur ne SPE, KVO konstaton se operatori ekonomik “INA” SH.P.K, ka deklaruar se disponon te punesuar prane shoqerise vetem per:

- 3(tre) manovratore nga 4 (kater) te kerkuar, ndersa per **1 (nje) manovratore tjeter nuk rezulton i deklaruar ne Formularin Permbledhes te Vetedeklarimit si i punesuar** dhe i deklaruar ne listpagesat e shoqerise “INA” SH.P.K per periudhen Mars 2026 – Maj 2026,
- 2(dy) shofere nga 4 (kater) te kerkuar, ndersa per **2 (dy) shofere te tjere nuk rezultojne te deklaruar ne Formularin Permbledhes te Vetedeklarimit te punesuar** dhe te deklaruar ne listpagesat e shoqerise “INA” SH.P.K per periudhen Mars 2026 – Maj 2026,

Si perfundim KVO konstaton se Operatori Ekonomik “INA” SH.P.K nuk permbush kriterin 2.3.5, te DST-se ne lidhje me disponimin e 4 (kater) Shoferave dhe 4 (kater) Manovratorave dhe njekohesisht eshte ne shkelje të detyrimeve të zbatueshme që lidhen me legjislacionin e punës.

Sa me siper Komisioni i Vleresimit te Ofertave mbeshtetur nenin 77, pika 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve, si dhe ne në nenin 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, vendosi te refuzoje oferten e OE “INA” SH.P.K, per mos permbushje te kriterëve te vecanta kualifikuese.

Si perfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, OE “INA” Shpk, me Nuis J61814009W, skualifikohet.

III- Operatori Ekonomik “MELA.” Shpk, me Nuis K62320011G,

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐ JO X

Nga verifikimi i dokumentacionit ne SPE rezulton se OE ka dorezuar te gjithë dokumentacionin ne perputhje me kriteret e pergjithshme dhe te vecanta te kualifikimit te percaktuar ne dokumentat standarte te tenderit.

Komisioni i vleresimit te ofertave mbeshtetur në nenin 92, pika 3, ligjit nr.162/2020, “Për prokurimin publik”, ku parashikohet shprehimisht se: Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha

kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit.

Per sa me siper oferta e dorezuar nga OE “MELA.” Shpk, me Nuis K62320011G, eshte kualifikuar.

Ne vijim nga shqyrtimi i dokumentacionit te procedures se prokurimit konstatohet se me procesverbalin Nr. 01, Date 31/07/2026, për vleresimin e dokumentacionit per proceduren e prokurimit me objekt: “Ndertimi i Parkut “Nene Tereza” dhe Pedonales “Faik Konica”, Lezhe”, Komisioni i Vleresimit te Ofertave ka kualifikuar paraprakisht Operatorin Ekonomik “MELA.” Shpk, me Nuis K62320011G dhe me daten 31/07/2026, i ka kerkuar me ane te Sistemit te Prokurimeve Elektronike dorezimin e dokumentacionit fizik origjinal ose kopje te njehesuar me origjinalin sipas parashikimit në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j”, të pikës 2, të nenit 26, te VKM-se nr. 285, date 19.05.2022 “Per miratimin e rregulave te prokurimit publik”, te ndryshuar, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike deri me daten 16.07.2026.

Ne vijim, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, pasi mori në shqyrtim dokumentacionin e dorëzuar prane Bashkise Lezhe, me ane te shkreses me Nr. 15655 protokolli hyres, date 05.08.2026, nga Operatori Ekonomik “MELA.” Shpk, konstatoi se:

Se pari, nuk ploteson kriterin 2.3.3, te DST-se ku parashikohet se: Operatoret Ekonomike duhet te kene një punësim mesatar të paktën 31 (tridhjetë e nje) personave të siguruar për periudhen Mars 2026 – Maj 2026.

Për këtë ofertuesi duhet të paraqesë:

a) Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin nga muajt e kerkuar;

b) Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi.

Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatoret ekonomik te formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimimit.

KVO veren se bazuar ne piken 1 te nenit 26, te VKM-se nr. 285 date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, i ndryshuar, parshikohet se: *Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si prove paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose pale te treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla, dhe per te*

permbushur kete kriter operatoret ekonomik pjesmarres duhet te vetedeklarojne ne formularin permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se, te dhenat e stafit mbeshtetes qe disponon sipas percaktimeve te pikes 2.3.5 te DST-se.

KVO mban ne konsiderate se bazuar ne Formularin Permbledhes te Vetedeklarimit te paraqitur prane Bashkise Lezhe nga Operatori Ekonomik “MELA.” Shpk rezulton se ky subjekt per permbushjen e kriterit 2.3.3 te DST-se ka deklaruar se numri i punonjësve “MELA.” SH.P.K eshte 31 punonjes per periudhen Mars 2026-Maj 2026.

Nga verifikimi i dokumentacionit te dorezuar fizikisht prane AK rezulton Operatori Ekonomik “MELA.” Shpk ka paraqitur Listepagesat e shoqerise “MELA.” Shpk per periudhen e kerkuar Mars 2026 – Maj 2026 dhe rezulton se per Muajin Mars 2026 ky Operator ka te deklaruar 26 punonjes, per muajin Prill 2026 ka deklaruar 31 punonjes, ndersa per muajin Maj 2026 ka deklaruar 31 punonjes ku perfundimisht punesimi mesatar per periudhen e kerkuar i subjektit “MELA.” Shpk rezulton prej 29.3 punojeshish.

Sa me sipër, rezulton se Operatori ekonomik “MELA.” Shpk nuk disponon per periudhen Mars 2026-Maj 2026 një punësim mesatar të paktën 31 (tridhjetë e një) personave dhe per rrjedhoje ky kriter konsiderohet i papermbushur.

Se dyti, nuk ploteson kriterin 2.3.5, te DST-se ku parashikohet se: “Krahas stafit teknik Operatoret Ekonomike duhet te kene te punesuar staf mbeshtetes si me poshte:

- Inxhinier Ndërtimi	1 (nje)	Diplome Universitare
- Inxhinier Agromjediti/pyjesh	1 (nje)	Diplome Universitare
- Teknik ndertimi	2 (dy)	Diplome shkolles mesme
- Teknik Elektrik	1 (nje)	Diplome shkolles mesme
- Elektriçist	2 (dy)	Çertifikate/ Deshmi profesionale
- Betonues	2 (dy)	Çertifikate/ Deshmi profesionale
- Hekurkthyes	2 (dy)	Çertifikate/ Deshmi profesionale
- Karpentier	2 (dy)	Çertifikate/ Deshmi profesionale
- Plakashtues mermeri dhe guri	4 (kater)	Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale
- Saldator	1 (nje)	Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale
- Shofer	4 (kater)	Leje Drejtimi
- Manovrator	4 (kater)	Deshmi e Aftesise Profesionale (DAP)

Operatori ekonomik duhet te paraqes per stafin e mesiperm: Kontratat individuale te punës, Diplome Universitare/ Diplome e shkolles mesme/ Deshmite profesionale/ Deshmi te Aftesise Profesionale (DAP)/ Leje Drejtimi sipas shenimeve per cdo kategori te mesiperme si dhe stafi i mesiperm te figuroje ne listepagesat e shoqerise per periudhen Mars 2026 – Maj 2026.

V.O- Dokumentacioni (Diplomat/deshmite/certifikatat) qe nuk eshte leshuar sipas legjislacionit perkates te arsimimit profesional do te konsiderohen jo te sakta dhe behen shkak per veprime te metejshme sipas parashikimeve perkatese te ligjit te prokurimit publik.

Per profesionet si me sipër, operatori ekonomik duhet te plotesoje tabelën si me poshtë:

Nr.	Emer Mbiemer i punonjesit	Profesioni i punonjesit ne certifikate/diplome	Emri i Institucioni publik/privat leshues i certifikates/diplomes	Numri indetifikues i certifikates/diplomes	Nr NIPT - (Ne rast se leshuesi eshte institutcion privat)
1					
2					
.....					

Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatorët ekonomik te formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe tabelës se mesiperme, te cila duhet te dorëzohet ne fazën e ofertimit ne SPE. Ndersa dokumentacioni provues i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit paraprak dhe fillimit te afateve te ankimimit.

KVO veren se bazuar ne piken 1 te nenit 26, te VKM-se nr. 285 date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, i ndryshuar, parshikohet se: *Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si prove paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose pale te treta, formularin përmbledhës të vetedeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla, dhe per te permbushur kete kriter operatorët ekonomik pjesmarres duhet te vetedeklarojne ne formularin permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se, te dhenat e stafit mbeshtetes qe disponon sipas percaktimeve te pikes 2.3.5 te DST-se.*

KVO mban ne konsiderate se bazuar ne Formularin Permbledhes te Vetedeklarimit te paraqitur prane Bashkise Lezhe nga Operatori Ekonomik “MELA.” Shpk rezulton se ky subjekt nder te tjera per permbushjen e kriterit 2.3.5 te DST-se ka deklaruar si me poshte:

- Z. I. Krrusa, me profesion Shofer, i punesuar pranë shoqërisë qe kemi mare mjetet me qira,
- Z. M. Alibeaj, me profesion Shofer, i punesuar pranë shoqërisë qe kemi mare mjetet me qira
- Z. G. Brati, me profesion Shofer, i punesuar pranë shoqërisë qe kemi mare mjetet me qira
- Z. B Tota, me profesion Manovrator, i punesuar pranë shoqërisë qe kemi mare mjetet me qira
- Z. L Ademaj, me profesion Manovrator, i punesuar pranë shoqërisë qe kemi mare mjetet me qira

KVO mban ne konsiderate se bazuar ne piken 1 te nenit 26, te VKM-se nr. 285 date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, i ndryshuar, parshikohet se: *Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si prove paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose pale te treta, formularin përmbledhës të vetedeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla, per te permbushur kete kriter operatorët ekonomik pjesmarres duhet te vetedeklarojne ne formularin permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se, te dhenat e stafit mbeshtetes qe disponon te punesuar dhe qe figuron ne listepagesat e shoqerise per periudhen Mars 2026 – Maj 2026, sipas percaktimeve te pikes 2.3.5 te DST-se.*

Nga verifikimi i Formularit Permbeledhes te Vetedeklarimit te paraqitur ne SPE rezulton se

Z. I. Krrusa, Z. M. Alibeaj, Z. G. Brati, Z. B Tota dhe Z. L Ademaj nuk jane te punesuar prane OE “MELA.” Shpk dhe per rrjedhoje ky subjekt **nuk disponon Kontrate Individuale te Punes me keta punonjes**, si dhe keta punonjes **nuk figurojne ne listepagesat e shoqerise “MELA.” Shpk per periudhen e kerkuar Mars 2026 – Maj 2026.**

KVO mban ne konsiderate se cdo marredhenie pune e pa formalizuar ne perputhje me ligjit te nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar eshte absolutisht e pavlefshem.

Per me teper, KVO thekson se marredhenia e punesimit me shoferat dhe manovratorët ne formen “i kontraktuar me mjetin”, **ku nuk jane lidhur kontratat individuale te punes dhe nuk jane deklaruar ne listpagesat e shoqerise si punonjes eshte absolutisht e pavlefshem dhe bie ndesh me dispozitat e ligjit te nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.**

Per sa me lart, konstatohet se Operatori Ekonomik “MELA.” Shpk **nuk disponon te punesuar dhe te deklaruar ne listpagesat e shoqerise per periudhen Mars 2026 – Maj 2026 punonjesit Z. I. Krrusa, Z. M. Alibeaj, Z. G. Brati, Z. B Tota dhe Z. L Ademaj dhe per me teper konstatohet se forma e marredhenies se punes npermjet kontrates se qirase me mjetin bie ne kundërshtim te hapur me ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.**

Per sa cituam me siper, si dhe bazuar ne dokumentacionin e dorezuar ne SPE rezulton se ky subjekt ka deklaruar te dhena per qellime kualifikimi ne lidhje me zbatimin e dispozitave ligjore ne marredheniet e punes, ku verehet se ka deklaruar si me poshte:

“D: DEKLARATA “Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës”

Deklarata Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se:

- **Operatori ekonomik “MELA.” Shpk garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.**
- **Operatori ekonomik “MELA.” Shpk lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.**
- **Operatori ekonomik “MELA.” Shpk nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH”.**

Per sa me lart Komisioni i Vleresimit te ofertave vlereson se OE “MELA.” Shpk eshte ne situaten e shkeljes së detyrimeve të zbatueshme që lidhen me legjislacionin e punës te parashikuar ne nenin 76, pika 3, e ligjit nr. 162, date 23.12.2020 “Per prokurimin publik”, ne te cilin citohet se: “Çdo operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në procedurën e prokurimit nëse është në një

*nga situatat e mëposhtme: a) autoriteti ose enti kontraktor provon se ka shkelje të detyrimeve të zbatueshme që lidhen me legjislacionin për mbrojtjen nga diskriminimi, legjislacionin mjedisor, social, **të punës**, në fuqi apo me marrëveshjet kolektive dhe aktet e së drejtës ndërkombëtare në lidhje me këto fusha, ku Republika e Shqipërisë është palë;*

Sa me sipër nga verifikimi i Formularit Permbledhës të Vetedeklarimit të paraqitur në SPE, KVO konstaton se operatori ekonomik “MELA.” Shpk, ka deklaruar se disponon të punësuar pranë shoqërisë vetëm për:

- 2(dy) manovratore nga 4 (kater) të kërkuar, ndërsa për **(dy) manovratorët e tjetër nuk rezultojnë të deklaruar në Formularin Permbledhës të Vetedeklarimit si të punësuar** dhe i deklaruar në listpagesat e shoqërisë “MELA.” Shpk, për periudhën Mars 2026 – Maj 2026,
- 1 (një) shofer nga 4 (kater) të kërkuar, ndërsa për 3 **(tre) shofere të tjerë nuk rezultojnë të deklaruar në Formularin Permbledhës të Vetedeklarimit të punësuar** dhe të deklaruar në listpagesat e shoqërisë “MELA.” Shpk, për periudhën Mars 2026 – Maj 2026,

Si përfundim KVO konstaton se Operatori Ekonomik “MELA.” Shpk, nuk përmbush kriterin 2.3.5, të DST-se në lidhje me disponimin e 4 (kater) Shoferave dhe 4 (kater) Manovratorave dhe njëkohësisht është në shkelje të detyrimeve të zbatueshme që lidhen me legjislacionin e punës.

Sa me sipër Komisioni i Vlerësimit të Ofertave mbështetur nën 77, pika 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve, si dhe në nën 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, vendosi të refuzojë ofertën e OE “MELA.” Shpk, për mos përmbushje të kriterëve të vecanta kualifikuese.

Si perfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, Operatori Ekonomik “MELA.” Shpk, skualifikohet.

IV-Bashkimi i Operatoreve Ekonomik “T & XH” Shpk, me Nuis L72121504I & “AGRO - KORANI” Shpk, me Nuis L13329801V,

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga Operatori Ekonomik rezulton se:

Se pari, nuk ploteson kriterin 2.3.1 të DST-se ku parashikohet se: “Operatoret Ekonomike duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës,

ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

- Për kontrata të realizuara me autoritete publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

7. Formularin e vlerësimit;
8. Kontratën/Kontratata;
9. Situacionin përfundimtar;
10. Akt Kolaudimi
11. Faturat tatimore të deklaruara në organet tatimore;
12. Çertifikatën e marrjes në dorezim/ Çertifikatën e perhershme të marrjes në dorezim

-Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

6. Kontratë sipermarrje;
7. **Leje për kryerje punimesh**
8. Situacionin përfundimtar;
9. Fatura tatimore të deklaruara në organet tatimore;
10. Çertifikatën e marrjes në dorezim/Çertifikatën e perhershme të marrjes në dorezim;

Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtarët e cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Shenim: Per punet e ngjashme te realizuara si BOE krahas dokumenteve te mesiperme duhet te paraqitet edhe kontrata e bashkepunimit ku percaktohet ndarja e zerave te punimeve ndermjet paleve, ndersa per punet e ngjashme te realizuara si nenkontraktor duhet te paraqitet kontrata e

nenkontraktimit ku percaktohen zerat e punimeve si dhe miratimi i autoritetit kontraktor/investitorit”.

Theksojme se per te permbushur piken 2.3.1, ne lidhje me dëshmitë për pervojen e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë pese viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, OE duhet te paraqesin dokumentacion per realizimin e puneve te ngjashme me vlere jo me te vogel se 50 % e vlerës së përllëgaritur të kontratës që prokurohet per nje objekt te vetem ose pune te ngjashme ku vlere totale e puneve eshte jo me te vogel se dyfishi i vleres limit te kontrates qe prokurohet. Po ashtu duhet te paraqesin dokumentacionin e kerkuar per kontratat të realizuara me autoritete publike apo per kontrata të realizuara me sektorin privat.

Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se njeri nga operatorët ekonomik pjese e BOE-se konkretisht OE “AGRO - KORANI” Shpk, me Nuis L13329801V, ka paraqitur si pune te ngjashme vetem 2 (dy) kontrata të realizuara me sektorin privat, me objekt *“Furnizimin, vendosjen dhe mirembajtjen e gjelberimit” dhe “F.V. Punime Gjelberimi GCI, Lungomare, Green Coast, Palasë”.*

KVO per efekt te percaktimit te dokumentacionit te nevojshem per permbushjen e pikes 2.3.1, te kriterëve te vecanta beri nje verifikim te thjeshte ne faqen zyrtare te Qendres Kombetare te Biznesit www.qkb.gov.al, lidhur me pronesine publike apo private te shoqerise porositese te punimeve me objektin e sipecituar ku nga verifikimi rezultoi shoqeri me 100 % kapital privat.

KVO mban ne konsiderates se per punet e ngjashme të realizuara me sektorin privat, OE duhet të paraqesin: Kontratë sipermarrje, **Leje per kryerje punimesh**, Situacionin përfundimtar, Fatura tatimore, dhe Çertifikaten e marrjes ne dorezim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes.

Nga verifikimi i dokumentacionit ne SPE rezuton se OE “AGRO - KORANI” Shpk per dy objektet e sipercituar ka paraqitur Kontratë sipermarrje, Situacionin përfundimtar, Fatura tatimore, dhe Çertifikaten e marrjes ne dorezim por nuk ka paraqitur **Leje per kryerje punimesh**, dokument ky i kerkuar ne kriterin 2.3.1 te Dokumentave Standarte te Tenderit.

Si me siper, duke qene se njeri nga anetaret e BOE-se nuk plotëson kërkesat e parashikuara ne DST për eksperiencat e mëparshme të ngjashme dhe ky kriter konsiderohet i papermbushur.

Se dyti, nuk ploteson kriterin 2.3.2, te kushteve te veçanta te kualifikimit, ku parashikohet se: *“Operatorët Ekonomike duhet të dëshmojnë se disponojnë licensë profesionale për zbatim punimesh në ndërtim si dhe për kategorite e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin licensën përkatë së të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 42, date 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:*

PUNIME TE PERGJITHSHME NDERTIMI

NP-1 A Punime gjërmimi në tokë.

NP-4 D *Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale.*

NP-12 A *Punime të inxhinierisë mjedisore*

PUNIME SPECIALE NDERTIMI

NS- 14 A *Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj*

NS-18 A *Punime topogjeodezike.*

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastruktura dhe Energji, (ose Ministrisë kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- ne, Nr.42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këto forme është kusht skualifikues”.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave thekson se për përmbushjen e këtij kriteri operatorët ekonomikë duhet të paraqesin licensë profesionale për zbatim punimesh në ndërtim e cila përfshin minimalisht kategoritë e mësipërme.

Po ashtu, KVO thekson se në rast të Bashkimit të Operatoreve Ekonomik secili prej anëtarëve duhet të disponojë licensë profesionale të zbatimit të punimeve, pasi objekti i kontratës është realizimi i punimeve të ndërtimit në përputhje me ligjin Nr. 8402, datë 10.9.1998 “*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*”, i ndryshuar.

KVO mban në konsideratë në nenin 3, pikë 1 dhe 11, si dhe nenin 8/1, të ligjit Nr. 8402, datë 10.9.1998 “*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*”, i ndryshuar, përcaktohet se:

3/1. “Punime ndërtimi” janë të gjitha punimet e ndërtimit për objektet që ndërtohen ose instalohen në territor, me vendosje të palëvizshme apo të përkohshme, që zhvillohen nën ose mbi tokë, çdo proces ndërtimi, gjurmimi, prishjeje, zgjerimi, riparimi, rinovimi, si dhe çdo ndërhyrje tjetër në territor”.

3/11. “Zbatues i punimeve” është personi juridik, vendës apo i huaj, i licencuar për të ushtruar veprimtari në zbatimin e punimeve të ndërtimit, sipas klasifikimeve dhe kategorive të punimeve që ka të përcaktuar në licensë, i cili është përgjegjës për realizimin e punimeve të ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik”.

8/1. “Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendës apo të huaj, të pajisur me licensën përkatëse për zbatim punimesh ndërtimore”.

Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se njëri nga operatorët ekonomikë pjesë e BOE-se konkretisht OE “AGRO - KORANI” Shpk, **nuk ka paraqitur licensë profesionale** për zbatim punimesh në ndërtim dhe për rrjedhojë bazuar në ligjin Nr. 8402, datë 10.9.1998 “*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*” i ndryshuar, nuk mund të kontraktohet si zbatues punimesh.

Per me teper, KVO veren se anetari i BOE-se, OE “AGRO - KORANI” Shpk, **ne deklarimin e tij ne shtojcen 8, Formulari Permeledhes i Vetedeklarimit, ne pjesen II: “SHKAQET E PËRJASHTIMIT A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT”**, ka deklaruar si me poshte:

“Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi. Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme: Shoqeria "AGRO-KORANI" Sh.p.k., ushtron aktivitetin e tij ne fushen e Importit, prodhimit dhe tregtimit te fidaneve dekorative dhe frutore, luleve natyrale dhe plehrave kimike”.

KVO mban ne konsiderate se **ne formatin e shtojces 8, Formulari Permeledhes i Vetedeklarimit, ne pjesen II: “SHKAQET E PËRJASHTIMIT A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT”** kerkohet qe operatoret ekonomike te deklarojne se *“Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi”.*

Po ashtu, KVO mban ne konsiderate se **per kete objekt kontrate per te ushtruar aktivitetin në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi “Zbatues i punimeve” duhet te jete i licencuar për të ushtruar veprimtari në zbatimin e punimeve të ndërtimit**, kjo bazuar ne ligjin Nr. 8402, datë 10.9.1998 *“Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”* i ndryshuar.

Sa me siper, bazuar edhe ne deklarimet e anetarit te BOE-se, Operatorit Ekonomik “AGRO - KORANI” Shpk **rezulton se ky subjekt nuk disponon license profesionale per zbatim punimesh ndertimi dhe per rrjedhoje per kete objekt kontrate nuk ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi**, pasi aktiviteti i ketij subjekti eshte ne fushen e Importit, prodhimit dhe tregtimit te fidaneve dekorative dhe frutore, luleve natyrale dhe plehrave kimike.

KVO veren se edhe ne raste analoge **Komisioni i Prokurimit Publik**, ne vendimin **nr. 442/2018**, ka mbajtur te njetin qendrim duke u shprehur se: *“Në këto kushte, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se shoqëria projektuese “E.B.S” sh.p.k., nuk posedon licencimet në kategoritë e kërkuara nga autoriteti kontraktues, për kryerjen e studimeve të fisibilitetit për objektin e kontratës koncensionare, e për rrjedhojë BOE ndodhet në kushtet e mospërmbushjes të kriterit të vecantë të vendosur nga autoriteti kontraktues në shtojcën 9 të dokumentave të koncensionit”.*

Per sa me lart, Komisioni i Vleresimit te Ofertave vlereson se anetari i BOE-se, Operatori Ekonomik OE “AGRO - KORANI” Shpk **nuk permbush kriterin 2.3.2 ne lidhje me disponimin e licenses profesionale ne zbatim punimesh e për rrjedhojë Bashkimi i Operatoreve Ekonomik ndodhet në kushtet e mospërmbushjes të kriterit të vecantë të vendosur nga autoriteti kontraktues.**

Se treti, nga verifikimi i dokumentacionit ne SPE rezulton se ky BOE nuk ka paraqitur shtojcen nr. 2 (Lista e çmimeve sipas zerave te preventivit) e cila eshte nje shtojce per tu paraqitur nga operatori ekonomik, te parashikuar ne DST, sipas formatit te meposhtem:

Shtojca 2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)
LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ZËRAVE TË PREVENTIVIT

Data: _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:** _____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** _____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë zërat në Formularin e listës së çmimeve sipas zërave të preventivit dhe grafikut të realizimit të punimeve duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar për secilin zë në preventiv. Zërat e preventivit pa çmim do të konsiderohen si zëra të paofertuar dhe do të çojnë në refuzimin e ofertës.

Oferta ekonomike e detajuar

Nr	Nr. Analizë	Përshkrimi i Punëve	Njësi	Sasia	Çmimi/ Njësi	Cmim i total
1.						
2.						
3.						
Shuma						
Fondi Rezervë						
Shuma						
TVSH						
SHUMA TOTAL						

Nënshkrimi i ofertuesit _____**Vula****Shënim:** Çmimet duhet të shprehen në Monedhën ____ (e kërkuar në dokumentat e tenderit)

KVO mban ne konsiderate se ne nenin 14, te VKM-se 285, date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, parashikohet se: *“APP-ja harton dhe miraton me vendim formatin e dokumenteve standarde të tenderit që do të përdoren gjatë procedurave të prokurimit, për çdo lloj procedure prokurimi sipas nenit 41, të LPP-së, dhe çdo tip kontrate”*.

Po ashtu KVO mban ne konsiderate se formati i shtojces nr. 2, per procedurat e prokurimit “E hapur / Pune” eshte miratuar me vendimin nr. 10, date 05.10.2022 *“Per miratimin e disa shitesave dhe ndryshimeve ne dokumentat standarte te tenderit per mallra, pune, sherbime per proceduren e prokurimit “Procedure e Hapur”, dhe ne vendimin nr. 02, date 09.06.2021 “Per miratimin e dokumentave standarte te tenderit per mallra, pune, sherbime per proceduren e prokurimit “Procedure e Hapur” dhe asnje autoritet kontraktor apo operator ekonomik nuk mund te modifikoje apo te ndryshoje formularet e miratuar ne DST.*

KVO konstaton se ne dokumentat standarte te tenderit te procedures se prokurimit me objekt “Ndertimi i Parkut “Nene Tereza” dhe Pedonales “Faik Konica”, Lezhe”, ne seksionin I, udhezime per Operatoret Ekonomike, ne piken A/2 b) percaktohet se: ***“b) Operatori Ekonomik duhet të konsultohet me të gjitha udhëzimet, formularët, termat dhe specifikimet në Dokumentet e Tenderit. Mosdhënia nga operatori ekonomik e të gjithë informacionit ose dokumentacionit të kërkuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor në Dokumentet e Tenderit, do të çojë në refuzimin e Ofertës”***.

Ndersa ne dokumentat standarte te tenderit te procedures se prokurimit me objekt “Ndertimi i Parkut “Nene Tereza” dhe Pedonales “Faik Konica”, Lezhe”, ne seksionin I, udhezime per Operatoret Ekonomike, ne piken B/4 percaktohet se: ***“Operatori Ekonomik paraqet Formularin e Ofertës në përputhje me formularin e paraqitur në Seksionin II: Të gjithë Formularët shoqërues duhet të plotësohen pa ndonjë ndryshim, nuk do të pranohet asnjë zëvendësues. Të gjitha vendet bosh duhet të plotësohen me informacionin e kërkuar”***.

Po ashtu ne dokumentat standarte te tenderit te procedures se prokurimit me objekt “Ndertimi i Parkut “Nene Tereza” dhe Pedonales “Faik Konica”, Lezhe”, ne seksionin I, udhezime per Operatoret Ekonomike, ne piken B/10 ***“Formati dhe nenshkrimi i ofertes”***, percaktohet se: ***“Në përgjigje të Njoftimit të Kontratës, cdo Operator Ekonomik paraqet ofertën sipas formularëve standard në këtë DT. Oferta nënshkruhet nga personi/personat përgjegjës të autorizuar për këtë qëllim”***.

Gjithashtu edhe ne vete formatin e shtojces nr. 2 (Lista e çmimeve sipas zerave te preventivit) eshte e percaktuar se: ***“Të gjithë zërave në Formularin e listës së çmimeve sipas zërave të preventivit dhe grafikut të realizimit të punimeve duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar për secilin zë në preventiv. Zërat e preventivit pa çmim do të konsiderohen si zëra të paofertuar dhe do të çojnë në refuzimin e ofertës”***.

Nga verifikimi ne SPE, verehet se OE nuk ka paraqitur Shtojcen nr. 2 te DST-se.

KVO nenvizon se formulimi i shtojcave dhe deklaratave te miratuara nga ligjvendi ne DST-ne e kesaj procedure eshte bere per faktin se te gjithë operatorët ekonomike te deklarohen me pergjegjesi te plote sipas formatit te miratuar, duke mos lene asnje mundesi shmangie nga deklarimet apo pergjegjesite qe marrin operatorët me ane ate ketyre deklarimeve.

Per me teper edhe **Komisioni i Prokurimit Publik** ka mbajtur te njejtin qendrim ne lidhje me plotesimin e shtojcave ne **vendimin nr. 210/2020**, ku ka theksuar se: **“Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik., ka ndryshuar përmbajtjen e shtojcës 3 “Formular i Sigurimit të Ofertës”, duke dorëzuar një “Formular” me përmbajtje të ndryshme nga ajo e përcaktuar në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt ankimi, duke shtuar rastin e mospërmbushjes së një kushti Ofertuesi ka dorëzuar një ofertë të pa përgjegjshme, i cili nuk është parashikuar në shtojcën e hartuar nga autoriteti kontraktor. Kjo bie në kundërshtim me kreun II “UDHËZIME PËR OPERATORËT EKONOMIKË”, seksioni 1 “Hartimi i ofertës”, pika 1.1 të dokumenteve të procedurës së prokurimit në të cilën është parashikuar se “Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këto DT. Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto DT do të refuzohen si të papranueshme.” Gjithashtu, vlen të theksojmë se, dokumentat standarte të tenderit, janë dokumenta, që autoriteti kontraktor ua vë në dispozicion kandidatëve dhe ofertuesve të mundshëm për përgatitjen e ofertave. Në hartimin e këtyre dokumenteve, autoriteti kontraktor duhet të përdorë dokumentat standarde të tenderit. Rrjedhimisht, që nga data kur ka hyrë në fuqi vendimi për miratimin e ndryshimeve të dokumentave të tenderit, të gjitha procedurat e prokurimit do të shpallen nga autoritetet kontraktore sipas setit te ri te dokumentave standarde te tenderit, të miratuara nga Agjencia e Prokurimit Publik, të cilat janë të detyrueshme për tu zbatuar si nga ana e autoritetit kontraktor ashtu edhe nga operatorët ekonomikë të cilët marrin pjesë në një procedurë prokurimi publik”.**

Nisur sa me lart, KVO duke marre ne konsiderate udhezimet per operatorët ekonomike ne DST-se dhe vendimin **nr. 210/2020 te KPP-se**, thekson se ne kete rast jemi përballë mosparaqitjes se një shtojce e cila është pjesë përbërëse e dokumentave të procedurës së prokurimit dhe është e detyrueshme që të plotësohet sipas formatit të miratuar nga organet ligjzbatuese, pasi mosdhënia nga operatori ekonomik i të gjithë informacionit ose dokumentacionit të kërkuar nga Autoriteti Kontraktor në Dokumentet e Tenderit, rrjedhimisht do të cojë në refuzimin e Ofertës.

Sa me siper Komisioni i Vleresimit te Ofertave mbeshtetur nenin 77, pika 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoje që vërtetohet nga referenca të

përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve, si dhe në nenin 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, vendosi të refuzojë ofertën e BOE “T & XH” Shpk, me Nuis L72121504I & “AGRO - KORANI” Shpk, me Nuis L13329801V, për mos përmbushje të kriterëve të vecanta kualifikuese.

Si perfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, BOE “T & XH” Shpk, me Nuis L72121504I & “AGRO - KORANI” Shpk, me Nuis L13329801V, skualifikohet.

* * *

Duke iu referuar procedurës së mësipërme, ju informojmë se operatorët ekonomikë të mëposhtëm janë identifikuar si të suksesshëm:

1- Operatori Ekonomik “PE - VLA - KU” Shpk, me Nuis K61716013M dhe me oferte ekonomike 97,840,578.5 (nentedhjetë e shtatë milion e teteqind e dyzet mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e tete pike pese) Lek pa Tvsh,

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐ JO X

2- Operatori Ekonomik “RAFIN COMPANY” Shpk, me Nuis L52125110A dhe me oferte ekonomike 101,416,948.75 (njqind e një milion e katërqind e gjashtembedhjetë mijë e nenteqind e dyzet e tete pike shtatëdhjetë e pese) Lek pa Tvsh,

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐ JO X

Si pasojë, nga ju kërkohet të paraqiteni tek zyra e protokollit të Bashkisë Lezhe brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e marrjes të këtij njoftimi për të lidhur marrëveshjen.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit, nga i cili nisin afatet e ankimit /Njoftimit të Anulimit, nga i cili nisin afatet e ankimit

PO ☐ JO X

Nëse Po (Nr. __ Datë __ i vendimit përfundimtar për shqyrtimin e ankesës, të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik)

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
KRYETARI
Pjerin NDREU